




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7129/24 datë: 19.03.2024



Npi – 01/116 datë: 28.03.2023

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 10 dhe 11 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26; Nenin 6 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore; Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020 Npi-01/264 dt.30.09.2009; Pëlqimin nga Ministria e Bujqësisë me numër të referencës ZSP-166/2024 të datës 29.02.2024, Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/188 të datës 18.03.2024, në seancën e mbajtur më 28.03.2024, miratoi këtë

V E N D I M

PËR NDRRIMIN E DESTINIMIT TË NGASTRAVE KADASTRALE ME Nr. 313-3, 313-4, 313-5, 313-6 PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “NRW – PARKU I DAVIDOCIT”

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.03.2024, unanimisht, miratoi Vendimin për ndërrimin e destinimit të Ngastrave Kadastrale me numër P-72809023-00313-3, P-72809023-00313-4, P-72809023-00313-5, dhe P-72809023-00313-6 në Zonën Kadastrale Davidoc, me sipërfaqe të përgjithshme prej 10248m², nga toka bujqësore në tokë jobujqësore, me qëllim të realizimit të projektit me bashkëfinansim në mes të Komunës së Shtimes dhe Qarkut UNA nga Gjermania “NRW – Parku i Davidocit”.

II

Ngastrat Kadastrale me numër P-72809023-00313-3, P-72809023-00313-4, P-72809023-00313-5, dhe P-72809023-00313-6, kanë sipërfaqe të përgjithshme prej 10248m², (01h.02a.48m) të gjitha gjenden te vendi i quajtur “Utrinë”, Z.K-Davidoc, Shfrytëzimi aktual, Kultura/ Kullosë e klasit të parë. Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes, e cila me këtë vendim destinohet sipërfaqe e parkut “NRW – Parku i Davidocit”.

III

A r s y e t i m: Kuvendi i Komunës, ka marrë parasysh edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/108 dt. 26.03.2024 si dhe propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/188 dt.18.03.2024 me arsyetimin se fshati Davidoc ka nevojë për një park me lojëra për fëmijë, dhe se nuk ka pengesa sipas Planit Zhvillimor të Komunës së Shtimes.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Kryetarit të Fshatit Davidoc dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit
Adnan Ademi